

13

“TANI ËSHTË MOMENTI”

Studimi i shpëtimit nuk duhet të jetë thjesht një ushtrim intelektual. Në qoftë se nuk e bën dikë që të pranojë ofrimin e shpëtimit nga Perëndia, ky studim nuk e ka përmbushur plotësisht qëllimin e tij. Në qoftë se nuk e ndryshon studentin në një farë mënyre, koha e shpenzuar për studim ka qenë e humbur.

MOMENTI PËR SHQYRTIMIN E VETES

Është momenti për të shqyrtuar veten. Është momenti që ju të jeni shumë të sigurtë me veten tuaj lidhur me nevojat e shpirtit tuaj. Unë nuk mund të përcaktoj se cilat janë nevojat e shpirtit tuaj. Vetëm ju mund ta bëni këtë. Duhet ta bëni këtë mbi bazën e mësimave të Fjalës së Perëndisë.

Së pari, pyesni veten nëse me të vërtetë besoni te Perëndia, te Jezusi dhe te Bibla. Në qoftë se keni shumë dyshime, folini për to atij që ju tregoi për këto mësim. Mund të keni nevojë për studim të mëtejshëm. Gjithashtu ju nxis të lexoni Biblën, sepse “besimi . . . vjen nga fjala e Perëndisë” (Romakëve 10:17; shikoni gjithashtu te Gjoni 20:30, 31). Në qoftë se besoni te Jezusi, a jeni të gatshëm ta rrëfeni besimin tuaj?

Më tej, a jeni të ndërgjegjshëm për mëkatet tuaja dhe për gjendjen tuaj të humbur? A jeni gati të angazhoheni të jetoni një jetë më të mirë me ndihmën e Perëndisë?

Në qoftë se në këtë pikë përgjigja juaj është “po”, pyesni veten në qoftë se jeni pagëzuar sipas Biblës. Pyetja nuk është nëse keni kaluar nëpër një rit të quajtur “pagëzim”, por nëse jeni pagëzuar ashtu si mëson Dhjata e Re. Shikoni pyetësin që shpresojmë e keni plotësuar, kur filluat leximin e këtij studimi. Krahasoni atë që keni shkruar me atë që Bibla thotë për pagëzimin. (Rishikoni

mësimet “Çohu dhe ji i pagëzuar (1)” dhe “Çohu dhe ji i pagëzuar (2)”.) Në qoftë se pagëzimi juaj nuk është bërë ashtu si përshkruhet në Bibël, sigurisht që do të donit të pagëzoheshit përsëri, sipas Shkrimeve. Flisni me atë që ju tregoi për këto mësim në internet. Ai do t’ju ndihmojë për këtë.

Në qoftë se pagëzimi juaj ishte sipas Biblës, atëherë duhet të pyesni për adhurimin që bëni. A keni qenë duke adhuruar dhe duke shërbyer me një kishë si ajo që përshkruhet në Dhjatën e Re?

Ndoshta nuk jeni anëtar i ndonjë trupi fetar. Në qoftë se është kështu, ju inkurajoj përsëri që të shqyrtoni kishën e Krishtit që ndodhet afër jush. Anëtarët e kishës së Krishtit ju inkurajojnë që t’i “vini në provë” ata (1 Gjon 4:1). Ai që ju ftoi t’i lexoni këto mësim ka mundësi të jetë anëtar i kishës së Krishtit. Në qoftë se është, ai do t’i mirëpresë pyetjet tuaja.

Nga ana tjetër, ju ndoshta keni qenë anëtarë të ndonjë organizate apo grupi fetar. Në qoftë se është kështu, duhet ta shqyrtoni organizatën apo grupin tuaj nën dritën e asaj që Dhjata e Re na mëson për kishën. (Rishikoni mësimet 6 deri 11 të këtij studimi) Përdorni procedurën që dhamë në mësimin “Misioni i kishës së Jezusit”. Në qoftë se kisha ku jeni anëtarë nuk është sipas modelit të dhënë nga Shkrimet, duhet të shikoni tjetërkund për një shtëpi shpirtërore.

KOHA PËR T’U BINDUR

Pasi të kuptoni se çfarë duhet të bëni, është e detyrueshme që të mos vonoheni. Duhet të veproni menjëherë. Ndërsa përfundojmë studimin tonë, ju kërkohet që të shqyrtoni tre vargje të Biblës:

Vargu i parë është Jakobi 4:17. Jakobi tha:

“Ai, pra, që di të bëjë të mirën edhe nuk e bën, bën mëkat.” A e dini ju “të mirën”? A e dini se duhet të pagëzoheni? Në qoftë se e dini por nuk e bëni, është mëkat. A keni nevojë të ktheheni te Perëndia? Në qoftë se dështoni në bërjen e kësaj, është mëkat. A e dini se duhet të bëni ndryshime për sa i përket fesë suaj? Në qoftë se refuzoni të bëni atë që dini se duhet bërë, mëkatoni.

Vargu i dytë është Gjoni 14:15. Jezusi tha: “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia.” Në qoftë se e doni Jezusin dhe keni nevojë të pagëzoheni, do të pagëzoheshit. Në qoftë se e doni Jezusin dhe keni nevojë të ktheheni te Perëndia, do të ktheheshit. Në qoftë se e doni Jezusin dhe keni nevojë të ndryshoni nga ana fetare, do ta bënit atë ndryshim.

Vargu i tretë është 2 Korintasve 6:2. Pali shkroi: “Sepse ai thotë: «Në kohë të pëlqyer unë të dëgjova dhe në ditë shpëtimi të ndihmova.» Ja, pra, koha e pëlqyer, ja, pra, dita e shpëtimit.” Pasi të kuptoni se çfarë duhet të bëni, por nuk veproni, një prej tri gjërave të mëposhtme mund të ndodhë:

- Zoti mund të kthehet para se ju të bindeni. Bibla thotë të qëndroni gati për kthimin e tij, “sepse Biri i njeriut do të vijë në atë orë kur ju nuk mendoni” (Mateu 24:44). Ai mund të vijë sot në qoftë se është vullneti i Perëndisë.
- Mund të vdisni para se të bindeni. Asnjëri nuk e zgjat dot jetën. “. . . është caktuar që njerëzit të vdesin vetëm

një herë, dhe më pas vjen gjyqi” (Hebrenjve 9:27).

- Zemra juaj mund të ngurtësohet. Sa herë që dikush refuzon ftesën e Jezusit, zemra e tij ngurtësohet edhe më shumë. Bëhet gjithnjë edhe më e vështirë t’i bindesh Jezusit dhe gjithnjë e më e lehtë ta refuzosh atë. Zemra e një njeriu mund të ngurtësohet aq shumë sa që është e pamundur që ai të pendohet (Hebrenjve 6:4–6). Hebrenjve 4:7 na nxit: “Sot, në qoftë se e dëgjoni zërin e tij, mos u bëni zemërgur.”

KONKLuzion

Shpresoj se studimi ynë së bashku ju ka ndihmuar të kuptoni se çfarë duhet të bëni për “t’iu afruar Perëndisë” (Hebrenjve 7:25; Jakobi 4:8). Në qoftë se ju ka ndihmuar, lutem që të mos vonoheni për të bërë atë që e dini se duhet bërë. Flisni me atë që ju tregoi për këto mësimet. Ai është shumë i interesuar t’ju ndihmojë për të gjetur paqe sot dhe shpresë për të nesërmen.

Është dëshira ime e sinqertë të marr kurorën e jetës (Zbulesa 2:10). Dua të shkoj në qiell, ku “Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë [tanë]; dhe vdekja nuk do të jetë më; as brengë, as klithma, as mundim, sepse gjërat e mëparshme shkuan” (Zbulesa 21:4). Lutem çdo ditë që të dashurit e mi të jenë atje. Gjithashtu, shpresoj që t’ju shikoj juve atje. Perëndia ju bekoftë! ❖

Autor: *David Roper*
Marrë nga studimi: “*Udhëzues për shpëtimin e të gjithëve*”
© 2001, 2003 E VERTETA PËR SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara